

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Shofer** pranë OSSH / Drejtori Rajonale / Dega e Shërbimeve Mbështetëse / Sektori i Transportit.

SHOFER

Shoferi është përgjegjës për transportin e sigurt, të rregullt dhe efikas të stafit, dokumenteve apo materialeve të institucionit. Siguron mirëmbajtjen bazë të automjetit, respektimin e rregullave të qarkullimit dhe zbatimin e procedurave të brendshme të institucionit.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Kryen transportin e stafit, dokumenteve dhe materialeve të nevojshme, sipas udhëzimeve të eprorit.
- Siguron drejtimin e mjetit në mënyrë të sigurt, profesionale dhe në respekt të plotë të rregullave të qarkullimit rrugor.
- Respekton itinerarin, oraret dhe axhendën e përcaktuar për udhëtimet.
- Kryen kontroll ditor të gjendjes së mjetit (niveli i vajit, ujit, gomave, dritave dhe funksioneve të tjera bazë).
- Ndjek rregullisht pastrimin e brendshëm dhe të jashtëm të mjetit.
- Monitoron harxhimin e karburantit dhe raporton çdo devijim ose problem.
- Kontrollon vlefshmërinë e dokumentacionit të detyrueshëm të qarkullimit (siguracion, taksa, kolaudim).
- Ndjek dhe raporton nevojat për mirëmbajtje apo riparime tek sektori përkatës.
- Ndhmon në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për riparimin dhe mbajtjen funksionale të mjetit.
- Bashkëpunon ngushtë me sektorin e mirëmbajtjes dhe njofton menjëherë për çdo defekt teknik.
- Raporton te eprori për çdo situatë të paparashikuar gjatë udhëtimit.
- Mban regjistrin ditor të lëvizjes së mjetit, kilometrazhin dhe karburantin e konsumuar
- Përmblush detyra të tjera të ngarkuara nga eprori i drejtpërdrejtë, në përputhje me natyrën e pozicionit.

KUALIFIKIMET DHE KËRKESAT

- Arsim të mesëm.
- Leje drejtimi e vlefshme, kategori B (ose kategori të tjera sipas llojit të mjetit).
- Përvojë e mëparshme si shofer shërbimi përbën avantazh.
- Njohuri të mira të rregullave të qarkullimit rrugor.
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të respektuar afatet.
- Integritet, korrektesë, kujdes dhe përgjegjshmëri maksimale gjatë punës.

DOKUMENTAT PËR DORËZIM:

- Curriculum Vitae (CV).
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendeni se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.